



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 6 dhjetor 2010, në mbledhjen e VIII (tetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 11.00. Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit. Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Radisav Peroviq, z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama, ndërkaq mungoi z. Arbresha Hetemaj. Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje. Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë në Podujevë - Njësiti për komunitete, z. Habil Sylejmani Komanda Rajonale Kufitare Veriu – Lluzhan, z. Mefail Mustafa, OSBE – Zyra regjionale Ekipi për komunitete, z. Suzana Kourilova, LMT – KFOR dhe Zacquelin Davis-Moran, z. Remzije Ibrahim, Shqipe Derguti dhe z. Arbnore Ymeri - Mikullovc, ICITAP,

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, propozoi që në rend dite të përfshihet edhe:

- Ngritja e Komisionit për hartimin e raportit të punës për vitin 2010 dhe propozimit të Planit të punës për vitin 2011

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri me plotësimin e propozuar nga kryesuesi.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 3 nëntor 2010

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozimi i Vendimit për mënyrën e përdorimit të Emblemës të Komunës së Podujevës

z. Nebih Behluli, nënvizoi se kjo çështje është shqyrtuar në Kuvendin e Komunës dhe se është miratuar Vendimi për vënie në diskutim publik të propozimit të këtij vendimi dhe shtoi se rregullimi i mënyrës së përdorimit të Emblemës së komunës është obligim ligjor andaj i njëjti do duhej të përkrahet me ndryshimet dhe plotësimet që do të propozohen gjatë debatit publik, përkatësisht ndryshimet dhe plotësimet të cilat do të miratohen në Kuvend të Komunës.

Propozimi i këtij vendimi u përkrah njëzëri.

4. Propozimi i Rregullores për përbërjen, kompetencat dhe rregullat e punës të Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Podujevës

z. Nebih Behluli, theksoi se edhe propozimi i kësaj Rregulloreje është shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvend të Komunës dhe se ky propozim është vënë në diskutim publik.

Përndryshe, shtoi ky diskutues, është hera e parë që kjo çështje rregullohet me akt normativ dhe se deri më tani kanë funksionuar vetëm Komitetet obligative përkatësisht Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, mirëpo pas miratimit të kësaj Rregulloreje do të krijohen kushtet më të favorshme për funksionalizimin edhe të Komiteteve joobligative, në përbërjen e të cilave janë edhe ekspert të lëmive të ndryshme nga shoqëria civile.

z. Mefail Mustafa, e përkrahu propozimin e kësaj Rregulloreje dhe sugjeroi që e njëjta të plotësohet si vijon:

Te Komiteti për Komunitete, përkatësisht nenin 11, në kuadër të përbërjes së këtij Komiteti, të shtohet edhe çështja e përfaqësimit gjinor, gjithashtu në nenin 12.1 të Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe nenin 14.1 të Komiteti për Zhvillim Ekonomik, në kuadër të përbërjeve të tyre të shtohet çështja e përfaqësimit etnik.

z. Nebih Behluli, u pajtua me propozimin e parafolësit dhe shtoi, Komitetet joobligative janë të ngritura nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, u pajtua me diskutimet e parafolësve.

Pas votimit u konstatua se propozimi i kësaj Rregulloreje u përkrah njëzëri.

5. Ngritja e Komisionit për hartimin e raportit të punës për vitin 2010 dhe propozimit të Planit të punës për vitin 2011

Komisioni për hartimin e raportit të punës për vitin 2010 dhe propozimit të Planit të punës për vitin 2011, u ngritë njëzëri në këtë përbërje:

1. Jahë lahu, kryetar
2. Nebih Behluli, anëtar dhe
3. Burhan Blakçori, anëtar

6. Të ndryshme

z. Remzije Ibrahim, foli për punët dhe aktivitetet e bëra të Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi në kuadër të ICITAP (Programi ndihmës trajnues ndërkombëtar për hetimin e krimit), program i përkrahur nga Ministria e Drejtësisë e SHBA-ve përmes Ambasadës së SHBA-ve.

Jemi të informuar për brengat dhe shqetësimet e komunitetit RAE dhe do të thellojmë bashkëpunimin e mëtejshëm në mënyrë që në të ardhmen të identifikojmë por edhe të angazhohemi që të realizojmë projekte të cilat janë në interes për komunitetet e cekura.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi se komuniteti ashkalinj dhe rom në Komunën e Podujevës është plotësisht i integruar në të gjitha sferat e jetës, siguria është në nivel mirëpo problem paraqet çështja e strehimit dhe punësimit që mund të thuhet se është në zero si dhe niveli i ulët i arsimimit.

z. Nebih Behluli, u pajtua me parafolësin dhe shtoi, pjesëtarët e komunitetit ashkalinj dhe rom, edhe para lufte edhe pas lufte, kanë qenë dhe janë njerëz të sjellshëm.

Sa i përket shkollimit nxënësit e këtyre komuniteteve mësimet i fillojnë mirë, kanë talent dhe inteligjencë mirëpo mjerisht një numër i tyre e braktisin shkollimin, andaj në këtë drejtim të gjitha subjektet relevante duhet të ndërmarrin masat dhe aktivitetet e nevojshme.

Me dispozita ligjore është i paraparë mësimi joformal i cili zgjatë 18 javë lidhur me këtë duhet informuar të gjithë ata të cilët i kanë ndërprerë mësimet në shkollë të mesme që përmes kësaj mundësie të pajisen me diploma përkatëse.

z. Jahë Lahu, u pajtua me parafolësin se një numër i nxënësve të komunitetit ashkalinj dhe rom e braktisin shkollimin dhe shprehu mendimin se për evitimin e kësaj dukurie duhet angazhuar në veçanti në vetëdijesimin e prindërve të atyre nxënësve.

Ka programe për mësim plotësues, siç është një organizatë Zvicreane, mirëpo për fat të keq nuk kemi objekt ku do të mbaheshin ato mësimet, andaj bazuar se shkolla më e afërt është 1.5 km. Do të ishte mirë të shqyrtohen mundësitë për ndërtimin e një objekti për shkollim të ulët në rrugën "Ali Ajeti" në Podujevë.

z. Nebih Behluli, u pajtua me parafolësin dhe shtoi në rrugën "Ali Ajeti" është një lokacion në pronësi të Komunës ku mund të ndërtohet një objekt shkollor.

z. Mefail Mustafa, nënvizoi, në Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptian të Qeverisë së Kosovës, të miratuar në dhjetor 2008, në komponentën për arsimin dhe edukimin e komuniteteve në fjalë parashihet që

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të përgatis kuadro të mësuesve dhe asistentëve të mësuesve.

Gjithashtu MASHT-i do të zbatoj modelin e Asistentëve Mësues për arsimin parashkollor (zëvendës edukatorët) si dhe për arsimin në shkollë të ulët fillore.

Gjithashtu do të zhvilloj dhe zbatoj një program të akredituar të trajnimit për Asistentët Mësues dhe do të certifikoj Asistentët Mësues.

Zacuelin Davis-Moran, Fillimisht u prezantua dhe shprehu kënaqësinë që është ftuar dhe merr pjesë në këtë mbledhje dhe shtoi në Kosovë kam qenë në vitet 1999-2000 dhe jam e lumtur që po shoh ndryshime të mëdha.

Është e vërtetë se keni probleme mirëpo duhet ta kemi të qartë se me ato probleme ballafaqohet shumica e qytetarëve të Kosovës.

Po shoh njerëz të brengosur por më vjen mirë që ata njerëz së pari dëshirojnë por edhe bëjnë përpjekje dhe angazhohen që t'i zgjidhin ato probleme.

Ju dëshiroj suksese në të ardhmen, përfundoi kjo diskutuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00 .

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01/297-06

Podujevë,

6 dhjetor 2010

Kyesuesi i Komitetit

Shaban Ahmeti